5 Pë. Jo, s'më kujtohet. S'po di qysh me ta spjegu z. Avokat.

6 Nuk po di. U konë një farë kohe, një farë, që ia nisën me i

7 dëbu njerëzit krejt prej shpije, prej, me i largue ushtria

8 serbe. Ka qenë ajo kohë, ndryshe s'po di si me ta spjegu këtë.

9 Py. Mbase të kujtohet stina e vitit, verë, dimër, kur?

10 Pë. S'më kujtohet, veç e di që dimër s'ka qenë, se s'ka pasë

11 borë. Ndoshta u konë një kohë pak e ftohtë po borë nuk ka pasë

12 në atë kohë. As se mbajna mend, ta kishim ditë që bash saktë,

13 na i ditë këto sende, bo vaki edhe e kisha mbajt mend taman

14 saktë, po se kena ditë.

15 Py. Bashkë me këta personat [REDAKTUAR] shkuat në

16 Zllash, kujt, tek cili raportuat, u lajmëruat aty?

17 Pë. Po. Shkuam në Zllash. Shkuam te Fatmir Sopi aty. Ishte një

18 Adem Shehu, një Triumfi ka qenë. Na u lajmërum tek ky Fatmir

19 Sopi. Na morën disa shënime, disa sende. Na thanë se mundni me

20 qëndru, duheni me bo disa stërvitje, disa aktivitete, ato

21 procedurat e tynve. Edhe okej, na vazhdum me nejt aty.

22 Py. Çfarë lloj të dhënash mbajti Fatmir Sopi nga ju? Çfarë

23 informacionesh ju mori?

24 Pë. Po ka marrë emër, mbiemër, datëlindje, kështu, ku jeton.

25 Shumë thjesht, shënime të tua personale.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W01679(Vijon) (~~Seancë private~~)(Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone Faqe 34
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. Ju bëri ndonjë pyetje tjetër?

2 Pë. Jo, jo. Nuk boni pyetje. Jeni ardhë me u kyç, me kontribu.

3 Po, okej. Faleminderit. Vazhdoni, kështu. Na tregoi se këtu

4 mundni me flejtë, me hangër, me pi, me flejtë, disa gjana edhe

5 nuk e kena zgjat shumë me të. Ma shumë kena pasë punë me Adem

6 Shehun, me disa stërvitje, me disa sende. Ma shumë kemi pasë

7 kontakt me të.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

9 Avokat, dy gjëra. Po i afrohem pyetjeve, të cilat mund të

10 bëhen në publik?

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe

13 tjetra është që po i afrohem orarit për pauzë.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Në fakt është një pjesë e gjatë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Pyetjet që u bënë në publik.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Mund t'i bëjmë pyetjet në publik,

18 por nëse e ndërpresim tani është një moment më normal pastaj.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

20 rregull. Znj. Sekretare të kalojmë në seancë publike.

21 [Seancë e hapur]

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës

23 jemi në seancë publike.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Z. Dëshmitar, ka ardhur momenti për pauzën e parë. Do të
2 bëjmë një pauzë prej 30 minutash. Do ti lutem shoqërueses
3 t'ju, të ndihmojë që të dilni nga salla e gjyqit. Do të
4 rishihemi në orën 11.30.

5 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
7 rifillojmë pas 30 minutash.

8 --- Pauza fillon në orën 10.56 paradite

9 --- Seanca rifillon në orën 11.30 paradite

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni
11 ju lutem. Në rregull. Jemi siç ishim më përpara? Po.

12 Prokuroria, Mbrojtja, Mbrojtësja e Viktimave, të gjithë janë
13 ashtu siç ishin.

14 Z. Mustafa po ashtu është aty. Përpara se të sjellim
15 dëshmitarin kam një kërkesë për ZPS-në.

16 Do ta vlerësonim nëse na dërgonit listën e dokumenteve që
17 doni të përdorni për Dëshmitarin W04603. Nëse është e mundur,
18 është një kërkesë.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, do ta bëjmë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
21 rregull.

22 Znj. Sekretare sill përsëri dëshmitarin në sallën e
23 gjyqit.

24 [Dëshmitari fillon dëshminë]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

1 se jeni kthyer përsëri z. Dëshmitar.

2 Tani do të vazhdojmë me pyetjet e Avokatit të Mbrojtjes
3 së z. Mustafa.

4 Z. VON BONE: Faleminderit shumë e nderuar.

5 Py. Z. Dëshmitar, pra, arritët në Zllash dhe ju njoftuat z.

6 Sopi, i cili mori të dhënat tuaja dhe aty e lamë përpara

7 pushimit. Po vazhdoj që nga ajo e tutje.

8 A u njoftove me emrin tënd, pa e thënë emrin tënd? Me

9 emrin tënd u njoftove?

10 Pë. Po, po me emrin tem, me të dhënat e mia.

11 Py. A mund të na thuash se ç'ndodhi më pas, pasi u njoftove

12 për t}u futur, për t}u kyçur në UÇK? Çfarë ndodhi më pas? Cili

13 ishte hapi tjetër që ndërmore ti vetë personalisht?

14 Pë. Ne s'morëm kurrfarë hapa. Neve na tregun se ku duhet me

15 flejtë, ku duhet me ndejtë, edhe vazhdum në atë shkollë

16 mandej.

17 Py. A mund të na thuash a nëse - çfarë mësove aty domethënë?

18 Pë. Aty mësuam disa stërvitje, disa ushtrime, disa këshill,

19 kështu gjona.

20 Py. A të caktuan ndonjë trajner të veçantë, ndonjë person që

21 të të stërviste ty pra posaçërisht?

22 Pë. Jo, jo, në atë stërvitje kemi qenë të gjithë kur kemi

23 shku. Ato stërvitje i ka kry ky Adem Shehu edhe një Triumfi,

24 ashtu i thojshin. Kur kemi shku me u stërvitë, kemi shku

25 q'ashtu kallabëllëk edhe me persona të tjerë ça janë konë aty.

1 Py. A të caktun, a u bashkove me ndonjë grup të rinjsh të UÇK-
2 së apo filluat të gjithë bashkë ashtu siç shkuat? Ju caktuan
3 bashkë apo si? Apo të caktuan në ndonjë grup të veçantë
4 njerëzish?

5 Pë. Jo, jo. Me të gjithë aty ça kanë qenë, se aty ka pasë edhe
6 shumë të tjerë. Të gjithë bashkë kena vazhdu ato aktivitetet,
7 ato stërvitjet, të gjithë bashkë. S'ke pasë kurrëgjë të
8 veçantë.

9 Py. A mund të na thuash sesi e kalove ditën e parë? Pra arrite
10 aty, të nesërmen në mëngjes çfarë ndodhi? Çfarë ndodhi
11 konkretisht? Çfarë stërvitje bëtë të nesërmen?

12 Pë. Të nesërmen jena dalë në një, a kanë si livadh aty poshtë,
13 atje ku janë kanë atje do, disa objekte të stërvitjes. Të kanë
14 shti me nga, -- me i bo disa stërvitje, disa zvarritje, disa
15 me u kap në do kanopa, do ksi sendesh. Si lloj ushtrimesh të
16 ushtrisë diçka kanë qenë këto.

17 Py. Sa veta ishit ju në grup?

18 Pë. Kur kena shku me u stërvitë, mujt me thanun aty në shkollë
19 ka pasë shumë. Po kur jena shku me u stërvitë, 17, 18, 20 vetë
20 kemi shku q'ashtu si grup. A në shkollë aty kanë qenë ma shumë
21 njerëz, kanë qenë.

22 Py. A mund të na i përshkruash një ditë të zakonshme
23 stërvitjeje? Pra na thuaj që kur çoheshe në mëngjes, pastaj
24 çfarë ndodh më pas? A mund të na i përshkruash një ditë të
25 zakonshme stërvitore?

1 Pë. S'po di qysh si me ta përshkru, po do shembull, ti je çu
2 në mëngjes, ke ndejtun me disa individë, disa shokë aty,
3 sende. Kur ardhë që ajo koha e stërvitjes kemi vazhdu me Adem
4 Shehun edhe Triumfin. Kemi vazhdu te pjesa ku ka qenë e
5 stërvitjes. Kemi kry aty disa stërvitje për, me thanun dy orë,
6 janë bo vaki edhe ndoshta dy orë, dy orë e gjys, pa marrë
7 parasysh deri sa jena lodhë mirë, sende. Jemi kthy në shkollë,
8 kemi ndejt, kemi hangër drekë për shembull ose diçka. Edhe
9 q'ashtu u shku ato ditë sa kam ndejt aty q'ashtu ka shku.

10 Py. A mund të na i përshkruash më konkretisht këtë stërvitjen?
11 Çfarë lloj stërvitjesh konkretisht? A mund të na i përshkrush
12 më me hollësi, keni bërë aty?

13 Pë. Po mujt me ta spjegu ndoshta pak ma shumë. Ke pasë druna,
14 kanopa për me u kap me hyp në to. Ke pasë me shku zvarrë. Ke
15 pasë druna me tela me shku zvarrë për me u zvarrit. Ke pasë
16 druna për me nga në to. Ke pasë druna për me bo ushtrime, disa
17 ushtrime q'ashtu.

18 Py. A të kujtohet ndonjëri prej atyre të pjesëtarëve të grupit
19 ku ishe ti? Nëse të kujtohet, a mund të na përmendësh
20 ndonjërin prej tyre me emër?

21 Pë. Cilit grup më fal?

22 Py. E kam fjalën për atë grupin që jeni stërvitë. The që ishit
23 17-18.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua
25 të sigurohemi që n.q.s. Dëshmitari do të përmendë emra, të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W01679 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone Faqe 39
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 kalojmë në seancë private. Sepse nuk e di se çfarë mund të
2 dali nga ato që do të thotë.

3 Prandaj për këtë pyetje të kalojmë në seancë private.
4 Pastaj kthehemi përsëri në seancë publike.

5 Kalojmë në seancë private.

6 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Vazhdoni Avokat. Mund ta përsërisni pyetjen besoj.

10 Z. VON BONE: [Përkthim]

11 Py. Z. Dëshmitar, kur dilnit për ato ushtrimet, stërvitje, the
12 se ishit një grup rreth 17-18 njerëzish apo jo? A mund të na
13 thuash emrin e ndonjërit prej personave në grupin me të cilin
14 shkuat të bënit këto ushtrimet stërvitore?

15 Pë. Po, zakonisht kam dalë me këta djemtë që kam shku. Me këta
16 [REDAKTUAR] edhe këta, po ka pasë edhe të tjerë. Ka
17 pasë emër [REDAKTUAR] ka pasë lloj-lloj emra
18 ka pasë tash, se kanë qenë një grup si i ri. Ka pasë disa
19 nofka dikujna, dikujna për shembull, zë shembull [REDAKTUAR]
20 Kjo është një nofkë e një djali, e thirrshin [REDAKTUAR] Ka
21 pasë lloj-lloj emna. Tash për momentin s'më kujtohen, po lloj-
22 lloj emra ka pasë.

23 Py. Dhe kur flinit, flinit veç e veç apo të gjithë bashkë?

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
25 fal që ju ndërpres. Nëse ka mundësi kalojmë në seancë publike.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W01679 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone Faqe 40
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Mbase është më mirë të rrimë në
2 seancë private, se mund të dalin prapë emra.

3 Z. VON BONE: [Përkthim]

4 Py. Pra, me kë flinit? Me kë flije? Flije vetë në një dhomë
5 apo me të tjerë? Nëse flije me të tjerë, a mund të na i
6 përmendësh disa prej emrave që të kujtohen?

7 Pë. Unë po t'i përmendi unë këta katër personat. Kom fjetë me
8 një dhomë, kam fjetë me atë [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR], me. Ne jemi konë në një dhomë me krevetë kështu
10 nga dy katëshe. Ka bo vaki ndoshta me një dhomë 12-13 vetë
11 kemi qenë. As më kujtohet saktë, po q'ashtu u konë pjesë-
12 pjesë. Kena pasë kreveta nga dy katë. Zakonisht ma shumë kom
13 ndejt me këta persona që kom shku, edhe aty ça jena shoqnu me
14 sa më kujtohet me këtë [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR], me disa persona ashtu që jena shoqnu aty.

16 Py. Këto janë këto të tre që the janë nofka apo janë emrat të
17 vërtetë?

18 Pë. Që kjo [REDAKTUAR] është nofkë. A këto [REDAKTUAR] e
19 këto, këto janë emra.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Mund të kalojmë në seancë
21 publike.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
23 lutem të kalojmë në seancë publike.

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi përsëri në seancë

Dëshmitari: W01679 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 41

Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 publike.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Avokat mund të vazhdoni.

5 Z. VON BONE: [Përkthim]

6 Py. Këto njerëz i ke takuar? Këto që i përmende me emër, a i
7 ke taku ndonjëherë mbas lufte?

8 Pë. Ndoshta i kom pa ndonjëherë, po kontakt nuk kom pasë me
9 ta, përveç ktyne persona që kam shku me ta.

10 Py. Pra ndenjët - për pesë ditë jeni stërvitë. Pyetja që kam
11 është kjo: Gjatë gjithë kohës ju ka stërvitë i njëjti person
12 ju si grup?

13 Pë. Po, i njëjti person.

14 Py. Kush ishte ky person?

15 Pë. Adem Shehu dhe ai Triumfi që po them.

16 Py. Po të tjerë a kishte që u stërvitën që i njef ti me emër?

17 Pë. Jo, të tjerë nuk kam ngjoftë me emër, dikush që na ka
18 stërvitë. Përpos ktyne dy personave, ato ditë sa kom qëndru
19 unë nuk ka pasë.

20 Py. Ky Adem Shehu dhe Triumfi, edhe ata aty qëndronin, aty
21 flinin në të njëjtën ndërtesë?

22 Pë. Po, aty kanë ndejtë aty po jo me neve. Aty kanë ndejtë se
23 aty ka pasë disa dhoma të ndame, ku ta di unë, shkollë, si
24 shkollë. Si shkollë, jo po ajo shkollë është, shumë thjesht
25 ajo shkollë. Po aty kanë qëndru edhe ata.

Dëshmitari: W01679 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 42

Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. E kisha fjalën në të njëjtën ndërtesë të shkollës po jo në
2 dhomën me ju.

3 Pë. Po. Po.

4 Py. Ajo, vendi ku stërviteshit, ku shkonit ju, ishte aty pranë
5 shkollës apo qe larg? A mund të na thuash pak a shumë ku
6 ndodhej?

7 Pë. Ajo ndodhet, u ndodhke shkolla si, si, i bike si në kodër
8 kështu, ajo ka qenë si, si në mes dy kodrave kështu. Ka qenë
9 me thonë nja, përafërsisht po them nja 15 minuta larg prej
10 shkollës. Po them përafërsisht se nuk e di saktë, po
11 përafërsisht aq sa ma merr menja mund që ecshim.

12 Py. Një prej personave që e ke përmendur më herët ishte një
13 femër. Kjo femra, edhe kjo qëndroi dhe fjeti në të njëjtën
14 ndërtesë me ju?

15 Pë. Në të njëjtën ndërtesë ka ndejt, në të tjera dhoma a ku ta
16 di unë, ama me neve në një dhomë nuk ka ndejtë.

17 Py. A të kujtohet përafërsisht sa femra kishte në atë shkollë
18 si rekrutë apo në cilësi të tjera?

19 Pë. Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet. Për femra nuk më
20 kujtohet. Për meshkuj kanë qenë shumë. Për femra nuk më
21 kujtohet. Edhe s'kemi pasë kontakt më aty kështu me femra me
22 diçka.

23 Py. Përpara se të kyçeshe në UÇK, a e dije ti nëse do të
24 pranonin apo jo? A është zhvillu ndonjë bisedë pak a shumë për
25 të, me ty apo me të tjerë për të kuptuar që a do të pranonit

Dëshmitari: W01679 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 43

Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 apo jo?

2 Pë. Jo, nuk kena zhvillu bisedë si me thonë, ku me ditë çfarë
3 bisede. Na jena shku, i kemi tregu se, "Jemi ardhë, a mujna me
4 u kyç, me kontribu ndonjë send?". Na kanë thanun, "Po mujni.".
5 Shënimet këto sende edhe q'kaq. Ne ma shumë s'kena pasun me
6 atë komandant. Edhe të ka pranun ai aty, d.m.th. ti e ke ditë
7 veten si i pranun. Por t'i ka marrë ato shënime, ato sende,
8 edhe të ka thonë, "Mundni me vazhdu me këto stërvitje." Ti e
9 ke ditë që je i pranun aty, që ndoshta duhesh me kontribu
10 ndonji send.

11 Py. A të bënë ndonjë pyetje se çfarë aftësish mund të kishe ti
12 për shembull që të të caktonit në një njësit apo zonë të
13 caktuar?

14 Pë. Jo, jo. Për momentin aty s'më kanë ba kurrfarë pyetje, veç
15 kanë thonë, "Duhet disa stërvitje, pastaj shohim." Po unë nuk
16 mujta, nuk pata kohë, s'më premtoi koha ma shumë me ndejt aty,
17 edhe kështu.

18 Py. Në një nga deklaratat që ke dhënë, më kujtohet është
19 deklarata, Pjesa 2, që ka bërë Prokuroria, e Rishikuar, faqja
20 2, Pjesa 2. Lexova që ke thënë, që në një ditë je marrë me
21 roje. Ke bërë roje.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
23 procesverbal është 060698-TR-ET.

24 Z. VON BONE: [Përkthim]

25 Py. Pra të mbahet mend që ke thënë që një ditë ke bërë roje?

Dëshmitari: W01679 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 44

Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Po.

2 Py. Roje e ke bërë vetëm apo me dikë tjetër?

3 Pë. Jo, kom bo roje me një individ tjetër. Po nuk a konë roje
4 ai, ose -- ato e kanë pasun që çdo ushtar ka me dalë nga një
5 orë, ma larg se shkolla tek një farë druni me këqyr, me
6 përcjell një farë rruge a ka lëvizje. U konë si lloj roje me
7 këqyr a ka lëvizje. Kur kam bo atë roje, e kam bo me këtë
8 Barabën, që po të them me [REDAKTUAR]. Aty kam ndejt,
9 aty e kena pasë çdo ushtar e ka pasë me rend me dalë në atë
10 farë pozicioni me këqyr apo ka ndonjë lëvizje të armikut
11 rrugës apo diçka.

12 Py. A të kujtohet, ato fqinjët me të cilët shkove në Zllash.

13 Ata që i përmende më herët. A e di se ça u ndodhi atyre? Ça u
14 bo me ta? Çfarë detyrash ju dhanë atyre?

15 Pë. Jo, nuk e di çfarë detyrash u kanë jep. Mbasi jam liru kur
16 kam shku i kam taku në shpi të vet. Ata më kanë thonë se mbasi
17 më kanë marrë mu edhe ata janë largu prej aty, kanë ikë. Mbas
18 disa ditëve edhe ata ishin largu, kishin ikë edhe janë kthy në
19 shpi të vet.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua
21 t'i kujtoj diçka dëshmitarit.

22 Z. Dëshmitar, mos përmend emra, as nofka sepse jemi në
23 seancë të hapur tani.

24 DËSHMITARI: Të kërkoj falje. S'muj t'përmbaj veten.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

Dëshmitari: W01679 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 45

Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 ke nevojë të kërkosh ndjesë. Është për të mirën tënde.

2 Z. VON BONE: [Përkthim]

3 Py. Në një moment aty në shkollë te Zllashi erdhën disa

4 person, të mbahet mend kjo?

5 Pë. Po.

6 Py. N.q.s. e kam të drejtë ishin katër persona që erdhën,

7 kështu?

8 Pë. Po ashtu ka qenë.

9 Py. N.q.s. nuk gabohe, njëri prej tyre shkoi te Fatmir Sopi,

10 dhe tre të tjerët ndenjën me ty. Kështu ka qenë?

11 Pë. Kështu ka qenë.

12 Py. Pse shkoi ky personi tek Fatmir Sopi? Pse u desh me shku?

13 Pë. Nuk di, nuk di ç'a kanë pasë punët e tyne, nuk di. Unë kam

14 ndejt q'aty me këta tre t'u pritë. Nuk di unë ç'a, pse u shku,

15 ç'a ka bisedu a çka, unë nuk di.

16 Py. Sa për të qenë të sigurt po të pyes. Je i sigurt që shkoi

17 te Fatmir Sopi, apo nuk e di që shkoi te Fatmir Sopi? Ai mund

18 të ketë shku në shkollë për ndonjë arsye për shembull.

19 Pë. Po ajo shkollë ka qenë aty krejt. Fatmir Sopi ka qenë si

20 një zyrë e vogël me një pjesë aty. Ai e kap krejt ka qenë aty,

21 shkoi hyni q'aty ku rrijshin Fatmir Sopi, që ky Adem Shehu e

22 qëta. Ai shkoi që u drejtu në q'atë pjesë atje, edhe s'më ka

23 interesu, edhe s'kam besu unë që po ndodh ksi gjona. Se kam

24 marrë me mend atë punë a e din? Tash ç'a ka bo brenda ai, ata e

25 dinë, unë s'di.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W01679 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone Faqe 46
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. A e mban mend emrin e personit që shkoi të takohej me
2 dikënd në shkollë?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e
4 dua ta themi në publik. Duhet të kthehemi në seancë private.
5 Të kalojmë në seancë private ju lutem.

6 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 Avokat vazhdoni.

11 Z. VON BONE: [Përkthim]

12 Py. Kush ishte personi? A ia di emrin ti? Ai personi që shkoi
13 në shkollë për të biseduar me këdo që ka biseduar.

14 Pë. Aty për aty për momentin nuk jua kam ditë emrat ktyneve po
15 ndërkohë i kom mësu këta emra, sa kam qëndru edhe aty, për
16 këtë Bimin dhe këta persona. Masnej i kam kuptu që ky Bimi, që
17 është [REDAKTUAR] dhe ai, masnej i kam kuptu. Se për në atë
18 moment unë nuk e kam ditë as çka shka ka ndodhë, as çka shka
19 bëhet, as.

20 Py. E kuptoj. Por mesa kuptova ti i njihje dy nga ata që
21 erdhën tek ty, kështu ka qenë?

22 Pë. Jo, unë nuk i kom njoftë ata që kanë ardhë me u marrë, po
23 masnej, ndërkohë unë i dëgjoja dhe krejt këta njerëzit. Aty
24 për momentin kur vjen një njeri direkt as nuk prezantohet, as
25 nuk të thotë kurrëgjja, as send, veç ndalet edhe duhet me këqyr

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W01679 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone Faqe 47
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 me të. S'di qysh munesh me e ditë ti. Po ndërkohë i kam mësu
2 emrat e tynve dhe janë mbetë në kry e s'harrohen këta
3 njerëzit.

4 Py. Pra edhe pse nuk ia dije emrin personit që u fut në
5 shkollë në atë moment, ti ia mësove emrin më pas. Dhe nëse
6 kështu si quhej ai? Nëse ka ndodhë kështu si quhej ai person?
7 Pë. Po, unë kam thonë për atë, [REDAKTUAR]. S'di a ka qenë
8 [REDAKTUAR]. Njoni prej tynve ka shku me bisedu. Këta tre të
9 tjerët kanë ndejtë aty me mu.

10 Py. A mund ta përshkruash [REDAKTUAR] të lutem? Ç'pamje
kishte?

11 Pë. [REDAKTUAR] muj me e përshkru pak, një njeri pak i gjatë,
12 ashtu pak si lloj muskulozi. Po d.m.th. ma i gjati prej tyne
13 ka qenë.

14 Py. Ndonjë përshkrim tjetër, diçka tjetër që mund të thuash
15 për të?

16 Pë. S'muj me përshkru diçka për të.

17 Py. Të tjerët që po rrinin me ty, që qëndruan me ty, me çfarë
18 ishin veshë?

19 Pë. Me uniforma të zeza, disa kapela.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj se mund të kalojmë në
21 seancë publike.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
23 Sekretare na kaloni në seancë publike, jo private, publike.

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: Të nderuar Gjykatës jemi në seancë

1 publike.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit znj. Sekretare.

4 Z. Avokat vazhdoni.

5 Z. VON BONE: [Përkthim]

6 Py. Kishin ndonjë shenjë, embleme të caktuar në rroba?

7 Pë. Po kanë pasë një lloj embleme me një farë shqiponje, që
8 asht shkru diçka BIA, ksi sende. Po kanë pasë emblema kanë
9 pasë.

10 Py. Po tregoje me gisht. A mund ta tregosh edhe njëherë me
11 gisht tek trupi yt ku e kishin atë emblemen si me thënë?

12 Pë. Kanë pasë emblema edhe këtu. Dikush e ka pasun edhe këtu,
13 dikush. Por shumica kanë pasë një farë lloj si e rrumbullakët
14 si embleme. Ka pasë në lloj-lloj pozicioni. Tash s'më kanë
15 interesu ato gjana bash me këqyr se ka qenë një moment që
16 s'kam pritun asi ngjarje që më ndodh mu.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
18 Avokat, të sqaroj diçka.

19 Z. Dëshmitar, në të majtë a në të djathtë të teshave
20 ishte emblema? Në të majtë a në të djathtë?

21 DËSHMITARI: Në këtë pjesën, në të majtë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
23 në rregull, se, ngaqë e mbajmë shënim, se thjesht për ta pasur
24 në procesverbal ku ishte.

25 Z. Avokat, vazhdoni.

1 Z. VON BONE: [Përkthim]

2 Py. Ishte, pra kur thatë në të majtë, në kraharor apo jo?

3 Pë. Po, edhe në kraharor ka pasë. Po ka pasë edhe ndërkohë

4 edhe ndonjë kur kemi qenë në atë objektin, ka mujt me pasë

5 nonji farë pseudonimi, ndonjë diçka të shkrume edhe këtu. Po

6 s'më ka interesu ajo punë, as për emblema apo ç'kanë qenë.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Jemi në seancë publike?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jemi

9 në seancë publike.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirë.

11 Py. Prej shkollës e tutje ku shkove?

12 Pë. Prej shkollës tutje vazhduam q'ashtu me ecë nëpër livadhe,

13 nëpër n'atë farë pjese edhe shkum te një objekt tjetër. Kur

14 shkua aty, ma qitën një send në kry, ulu, më shtinën me një

15 objekt.

16 Py. Ky objekti ishte larg?

17 Pë. Nuk ka qenë shumë larg prej shkollën me thonë, nja, ashtu

18 me atë mendimin tem, ça ma merr menja nja 20 minuta ndoshta

19 kemi ecë. Tash nuk e di saktë, po po thom ashtu përafërsisht

20 ndoshta nja 20 minuta.

21 Py. A të kujtohet, atë që ta qitën në kokë, a ta hoqën pastaj

22 nga koka? Kur ta hoqën të kujtohet se kur ta kanë hequr?

23 Pë. Po brenda, brenda ma kanë hjekun. Brenda se këta tan kohën

24 edhe aty poshtë kur më morën, thanë se "Ka punë diçka

25 komandanti me ty. Ka punë diçka. Ka me të pyt diçka." Ku ta di

- 1 unë. Edhe kur shkova aty ma hjekën.
- 2 Py. Në atë çast kur mbërrite aty ja dije emrin atij
- 3 komandantit?
- 4 Pë. Aty kur ka fillu, mu më pytën e ato sende edhe një farë,
- 5 kur ia ka nisë, po e kom mësu aty. Edhe e kom ditë se unë po
- 6 shkoj me më pyt diçka një komandant. Unë s'kam ditë as kush o
- 7 komandanti as. Këta qysh më kanë marrë, më kanë thonë, "Po të
- 8 çojna tek komandanti, ka me të pyt diçka." Edhe e kam ditë që
- 9 jam drejtu drejt q'atij njërit e kam ditë q'ai njeri është
- 10 komandant që më paska lyp me fol.
- 11 Py. Këtë komandantin na e përshkruan dot?
- 12 Pë. S'po kuptoj qysh me ta përshkru këtë.
- 13 Py. Pse nuk po na, -- pse nuk e përshkruan dot?
- 14 Pë. S'po di qysh me ta përshkru. Është i akuzuari yt që po e
- 15 mbron ti. Shumë thjesht veç ka mujt me qenë ndoshta pak një
- 16 trup më i dobët.
- 17 Py. Dua që të të kërkoj të na përshkruash personin, të cilin e
- 18 ke parë aty, d.m.th. këtë komandantin aty.
- 19 Pë. Po, komandanti po hyn e ish konë aty ul, tu nejt. Erdha,
- 20 tha "Që ta prunëm këtë komandant - këta të tjerët." Okej, më
- 21 pyeti kështu në një jakë me lara kështu si të ushtrisë. Ia
- 22 nisi tuj më pytë, "Për çka ke ardhë këtu?" Për disa gjana që
- 23 kështu. Unë i kallzova, "Jam ardhë me u kyç në luftë me
- 24 kontribu diçka". Ia nisi me ato bërtimat e veta, me ato
- 25 sjelljet e veta, "Jo po rren, jo kështu, jo kallzo, jo të

1 mys". Që ksi farë sendesh edhe u çu më goditi. Pastaj fillun
2 këta të tjerët tha, bile e vetën, tha, "Cal ça me bo?" sende
3 tha, "Mytne krejt këtë m..." Kështu ka qenë sa më kujtohet mu
4 ato gjana. Se ka gjana shumë që edhe sot s'më kujtohen. Po aq
5 sa po më kujtohen mu do gjana, po munohena pak me i sqaru.
6 Py. Çfarë ngjyre, çfarë ngjyre i kishte ato teshat që i kishte
7 veshë?

8 Pë. Qët jaknen e ka pasë ngjyrë taman të ushtrisë, kështu me
9 të gjelbër. Nuk ka qenë sikur këta me të zeza. Ka qenë një
10 uniformë tjetër. Dhe për të tjera s'po muj me ta spjegu.

11 Py. Nëse më kujtohet mirë, ato që na ke treguar, kjo ishte
12 hera e parë që të kanë rrahur apo jo?

13 Pë. Po kjo ka qenë hera e parë fillimi. Që ajo fillimi, që ajo
14 starti ka qenë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Avokat, dua t'i bëj një pyetje dëshmitarit.

17 Z. Dëshmitar, si ndihesh? Si je tani?

18 DËSHMITARI: Mirë, mirë, faleminderit. Po munohena me e
19 përmbajt veten.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
21 në rregull.

22 Sa herë të kesh nevojë për pauzë na thuaj pa problem.

23 DËSHMITARI: Faleminderit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

25 Avokat, mund të vijoni.

1 Z. VON BONE: [Përkthim]

2 Py. Pas të rrahurës, të çuan në ahur apo në atë si tip stalle
3 për lopë, sido që ta quajmë. Pra të çuan tek ky vendi tjetër
4 apo jo mbasi të rrahën?

5 Pë. Po.

6 Py. Na e përshkruaj pak këtë vendin, këtë ahurin sido që ta
7 quajmë. E kam fjalën sa i madh ishte.

8 Pë. Nuk ka qenë edhe shumë, shumë e madhe kjo pjesë. Nuk di sa
9 me të thënë e madhe, po ka qenë tokë, kashtë, si lloj kashte
10 të lopëve. Ka qenë me lagështi, ka qenë me druna, gurë, me ksi
11 sende. Sa ka qenë e madhe, s'po di si me të thonë, ndoshta sa
12 një dhomë diçka.

13 Py. A e kapje dot tavanin për shembull apo ishte më lart s'e
14 kapje dot me dorë?

15 Pë. Jo nuk më kujtohet, nuk di. S'më kujtohet. Edhe pse në atë
16 këtë kohë kam qenë ma i shkurt me trup, ma merr menja që unë
17 s'kisha muj me e mbri. Se kam qenë ma i vogël, ma i shkurtë.

18 Py. Sa hapa pak a shumë ishte nga njëra anë nga ana tjetër pak
19 a shumë?

20 Pë. Nuk di gjë z. Avokat. Nuk di.

21 Py. Po dritare të kujtohet a kishte?

22 Pë. Jo, sa më kujtohet, mu sa më kujtohet jo. Ka qenë veç ajo
23 derë, i ka pasë, ka qenë diqysh me ato dërrasat si të çame që
24 hyke ajo drita. Q'ajo derë ka qenë se për tjetër send nuk kam
25 vërejt që me thonë, se edhe s'jam konë në gjendje me këqyr

1 bash detaje, këto sende.

2 Py. 18 ditë gjithsej ke qëndruar aty. Kështu e saktë është
3 kjo?

4 Pë. Ditën e 18-të jam liru d.m.th. kam nejt.

5 Py. Pra i bie 17 netë ma merr mendja. Nga këto 18 ditë në sa
6 ditë të kanë rrahur?

7 Py. Pothuajse. S'di a ka ndonji ditë që ke pështu ma lehtë se
8 për me të rreh e ke pasun përditë. Se kush u hy aty, ndonjë
9 shkelëm ose ndonjë boks, ose diçka, pata thonë u konë e
10 pamujtshme, po ato kanë qenë më të lehta. Pothuajse gati
11 vazhdimisht ke pasë rrehje, torturë.

12 Po d.m.th. aty ke pështu ma lehtë ndoshta poshtë. Nalt u
13 konun shumë ma vshtirë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
15 Avokat, kjo është një pyetje, të cilën e bëmë dhe dje. Për
16 këtë kemi folur gjerësisht. Unë nuk dua t'jua ndërpres
17 pyetjet, po nuk do doja që të përsëriteshin.

18 Z. VON BONE: [Përkthim]

19 Py. Na the se të kanë rrahur shumë herë dhe se, në rastet kur
20 të rrifshin rëndë shumë të çonin lart, te dhoma lart.

21 Pë. Po.

22 Py. Po pyetje a nuk të bënë kur të rrihnin? Apo vetëm të
23 çonin lart edhe të rrifshin, aq. Apo të bënë edhe pyetje
24 gjatë herëve që të rrifshin?

25 Pë. Ka mujt me ndodhë se të kanë bo pyetje, "A je mundu me na

1 tregu. Për çka ke ardhë këtu?" Një farë kohe me q'ato fjalë,
2 tani mbas një kohe më bënë edhe hajn. Ma kthyn hajn. Edhe çka
3 kanë dashtë, ma thjesht çka kanë dashtë, qysh ju ka konvenu.
4 Kanë bo hajgare me njerëz.

5 Py. Komandanti ka qenë i pranishëm në secilin rast që të kanë
6 rrahë?

7 Pë. Jo nuk ka qenë i pranishëm në secilin rast. Ka ndodhë që
8 edhe s'ka qenë aty.

9 Py. Dhe nga gjithë këto herët që të kanë rrahur, sa herë nuk
10 ishte i pranishëm a të kujtohet? Sa herë nuk ishte ai i
11 pranishëm?

12 Pë. Nuk më kujtohet, po ka pasë raste që s'ka qenë i
13 pranishëm.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

15 Avokat, keni përdorur pak a shumë kohën e caktuar, por nëse ju
16 duhet më shumë kohë, do t'jua japim.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Patjetër që kam nevojë për më
18 shumë kohë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
20 kuptoj. Por edhe sa kohë ju duhet akoma sipas vlerësimit?

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj 20 e ca minuta.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
23 rregull, vazhdoni.

24 Z. VON BONE: [Përkthim]

25 Py. A është e vërtetë që dy femra kanë marrë pjesë në bërjen,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W01679(Vijon) (~~Seancë private~~)(Seancë e hapur)Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone Faqe 55
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 në marrje në pyetje apo gjatë rrahjeve?

2 Pë. E di që kanë qenë dy femra aty. Njëra bile, sot për pasojë
3 vuj hala, kam shenjë prej sajna. Po s'na kanë marrë në pyetje
4 ato, na kanë marrë në pyetje këta të tjerët, po ajo në atë
5 rast ndodhi, edhe e kam një, kam shenjë prej një femrës aty.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mos
7 ka ardhur çasti për të kaluar në seancë private, nëse do të
8 bëjmë pyetje të tjera mbi këtë pikë?

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
11 Sekretare, të kalojmë në seancë private ju lutem.

12 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: Të nderuar Gjykatës jemi në seancë
14 private.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit.

17 Z. Avokat mund të vazhdoni.

18 Z. VON BONE: [Përkthim]

19 Py. Z. Dëshmitar, këtë shenjë më duket sikur the, nga një prej
20 këtyre femrave.

21 Pë. Po, e kam një shenjë prej një femrës aty.

22 Py. Çfarë ndodhi?

23 Pë. Po këta ishin t'u më torturu aty, t'u ba hajgare, sende.

24 Unë nuk kom ditë kurrigjo. Ajo me hekur të nxehtë më sosi edhe
25 kështu që kjo më mbetë shenjë, që për pasojë e mbart edhe sot.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W01679(Vijon) (~~Seancë private~~)(Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone Faqe 56
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. Hekur i nxehtë. E ke fjalën për hekurin me të cilin

2 hekurosim teshat?

3 Pë. Asi hekri ka qenë se ajo u konë diçka duke bërë aty në atë

4 farë dhome, edhe unë se kom pa mbas shpine.

5 Py. Se mos e ka bërë pa dashje?

6 Pë. Ajo ndoshta këta i kanë bo pa dashje krejt këto që mi kanë

7 bo, këto pasoja që i mbart edhe sot, po nuk e di.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh

9 që është ngritur Mbrojtësja e Viktimave në këmbë.

10 ZNJ. PUES: [Përkthim] Po, kam kundërshtim për këtë

11 pyetje, sepse nuk është një përpjekje për të gjetur të

12 vërtetën, por është, të paktën mund ta quaj një pyetje

13 retorike, në mos diçka tjetër.

14 Dua të kërkoj më shumë vëmendje për të gjetur të

15 vërtetën.

16 Faleminderit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë

18 do ta lejoj këtë pyetje, por edhe dëshmitari i është

19 përgjigjur.

20 Z. VON BONE: [Përkthim]

21 Py. Z. Dëshmitar, çfarë lloj shenje të ka lënë kjo?

22 Pë. Kam shenjën që jam i sosun. Kjo a konë shumë e madhe, pak

23 u zvogëlu, por d.m.th. nuk u hjek përfundimisht. Nuk u hjek

24 kjo.

25 Py. Z. Dëshmitar, ke thënë se, ke deklaruar se të kanë

1 maltrajtuar dhe me rrymë. Pyetja që kam është: "Si ta lidhën
2 rrymën?" A mund të na e shpjegosh?

3 Pë. Muj me ta shpjegu për afërsisht. Këta prenë një kuti si
4 marrshin ato telat edhe t'i lidhshin të dy këmbët. Edhe kur e
5 prekshin atje një farë pulle d.m.th. më zejke rryma, ksi
6 sende.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
8 Avokat, kjo pyetje e ka marrë përgjigjen dje. Unë ngul këmbë -
9 kohë ju dhamë, kohë shtesë - por ngul këmbë që të mos
10 përsëritni pyetjet, të cilat janë bërë.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Është më shumë një pyetje që e
12 përdor si hyrje për të kalua në një pyetje tjetër.

13 Py. I kishe këmbët zbathur apo i kishe këpucët e veshura apo
14 tesha të veshura kur ta bënë këtë?

15 Pë. Kishe, po këtu kur ia nisën me të rreh aty, edhe këpucat
16 hupshin nëpër dhoma. Po d.m.th. ke pasë ti ato pantollat, po
17 ti çojshin lart, ti lidhshin në mish. S'ke pasë, s'ke guxu as
18 me lëvrit. Ça kanë dashtë kanë bo.

19 Py. Me sa vetë bëhej kjo?

20 Pë. Po këta zakonisht e kanë bo këta dy persona nëse mujt me i
21 përmend këta emra, nëse më lejohet.

22 Py. Patjetër.

23 Pë. Këtë e ka bo [REDAKTUAR]. Ky ish qenë
24 eksperti i asaj pune. Zakonisht këta të dy e kanë përdorur atë
25 mjet.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W01679 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone Faqe 58
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. A ta kanë bërë këtë ndonjëherë në praninë e komandantit?

2 Pë. Nuk e di, ndoshta nuk më kujtohet. Ndoshta. Nuk më

3 kujtohet se aty ka qenë ka qenë një vend që edhe mos me konë

4 q'aty ka ardhë dikush, ose edhe nuk ke mujt me u koncentru ti,

5 bash pusho, se ty të ka interesu qysh me mujt me ikë q'asajna,

6 me pështu pak, mos me ta nxjerrë shpirtin krejt ma shkurt.

7 Py. Ndonjëri prej tyre që të ka maltrajtuar ka pasur ndonjë

8 maskë ndonjëherë?

9 Pë. Jo, këta maltrajtusit e mi, çka i dëgjova unë që më ka

10 mbetë në kry, jo.

11 Py. Fole për një person të quajtur, siç e thotë Avokati

12 Bahria, Bahria [fonetikisht]. Në një prej deklaratave, mund të

13 shpjegosh kush është Bahria?

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ne e dimë se cila është

16 referenca, por në fakt për hir të procedurës duhet thënë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

18 edhe unë të njëjtën gjë do thosha.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Është Pjesa e Dytë, e Rishikuar,

20 RED3, në faqen 21.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Është referenca 060698-TR-ET,

22 Pjesa e Dytë, e Rishikuar, [REDAKTUAR], në rreshtin 12 të

23 faqes 21.

24 Py. Z. Dëshmitar, a mund të na thuash kush është Bahria,

25 Bahria?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W01679(Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone Faqe 59
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Ky sa e kam kuptu, ky ka qenë një zëvendës i Calit. Edhe e
2 njoh e kam afër. Po me mund aty me tortura me sende nuk ka
3 marrë pjesë ky. D.m.th. kaq di për të.

4 Py. Nga e njihje?

5 Pë. Po e njoh...a jam në seancë private apo?

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
7 në seancë private jemi.

8 DËSHMITARI: E njoh se [REDAKTUAR].

9 Z. VON BONE: [Përkthim]

10 Py. Po nga e di ti që ishte zëvendësi i komandantit?

11 Pë. Ashtu e kam kuptu edhe prej atij [REDAKTUAR] e prej
12 këtyneve se ky kinse u konë zëvendës i tijna. Edhe masnej kom
13 kuptu kështu prej njerëzve se si lloj zëvendësi [REDAKTUAR]
14 kish qenë.

15 Se mu s'më ka interesu ma shumë kjo pjesë. Nji njëri që
16 s'më ka keqtrajtu, s'më ka bo keq. Nuk më ka interesu për atë
17 punë.

18 Py. Ky është emri i vërtetë që ka apo është ndonjë nofkë?

19 Pë. Jo, ky emrin e vërtetë e ka [REDAKTUAR] e ky tjetri këtu
20 që është, [REDAKTUAR], ky është tjetër send. Këta nuk janë. Ky
21 dallon, ky është [REDAKTUAR] është tjetër send.

22 Py. Po mbiemrin si e ka ky [REDAKTUAR]?

23 Pë. Jo, s'ja di, s'më intereson. S'më ka interesu kurrë, po e
24 di që e ka emnin Bahri [REDAKTUAR] atje ma
25 nalt dikund.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W01679 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga Z. Von Bone Faqe 60
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. Z. Dëshmitar, dua të flasim për këtë [REDAKTUAR].

2 Pë. Po.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Për referencë jemi në të njëjtin
4 dokument, në faqen 32 n.q.s. nuk gabohe. Më falni është faqja
5 30, 31.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
7 çfarë pjese gjendet?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Ja po përpigem ta gjej. Po, është
9 faqja 30, rreshti 8 deri në rreshtin 13.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
11 cilën pjesë?

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Pjesa e Dytë, e Rishikuar, faqja
13 30. Fillon me [REDAKTUAR] në faqen 29, rreshti
14 18 dhe vazhdon deri në faqen 30, tek rreshti 18 dhe pastaj
15 vazhdon.

16 Py. Z. Dëshmitar, pra dua të diskutojmë bashkë për [REDAKTUAR]
17 [REDAKTUAR] Në dëshminë që ke dhënë Zyrës së Prokurorisë, ke
18 folur për diçka lidhur me të dhe do ta citoj. Pyetja është.
